

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik , Departamenti I Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjyques Shabi Idrizi dhe Sek. Juridike, Shpresa Hoxha, në lëndën penale të akuzuarit [REDACTED] nga fsh.[REDACTED] Kaçanik i akuzuar për shkak të veprës penale, vjedhje nga nen 325 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzes së Prokuroris themelore në Ferizaj PP.nr. 659-5/14 të datës 04.03.2015, pas mbajtjes së shqyrimit gjyqësorë oral dhe të hapur më 21.12.2016, në prezencë të Prokurorit Agim Kuka të akuzuarit [REDACTED], muarr dhe të njenjtën ditë shpalli publikisht këtë:

A K T GJ Y K I M

I akuzuari:

[REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e lindur [REDACTED] i lindur [REDACTED] fsh.[REDACTED] K-Kaçanik , , pregaditja shkolllore Shkolla e mesme, puntor,i gjendjes së varfër ekonomike, i martuar,nuk ka fëmij , deri më tani i padenuar, shqiptar nënshtetas Kosovar , mbrohet në liri.numri personal nuk posedon.

ËSHTË FAJTOR

Është fajtor me dt.20.02.2014 ne kohë të pacaktuar në fshatin Sllatine k.Kaçanik,përkatësisht ne shtëpinë e pabanuar të dëmtuarit [REDACTED] nga i njëjti fshat me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisësë luajtshme të tjetrit , e që vetit të i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm,kishte vjedhur kabllot elektrike te cilat kishin qene te vendosura ne mure,duke i shkaktuar dëme te dëmtuarit ne shumen rreth 150 euro.

Me ketë veprim kreu veprën penale vjedhje nga nen 325 par.1 të KPRK-së.

Andaj duke u bazuar në dispozitën e lartcekur dhe nenin 3, 41, 50 ,51 , 75 të KPK-së dhe nenit 365 dhe 453 të KPPK-së i shqipton

DENIM ME KUSHT

Të akuzuarit [REDACTED] i shqipton denim me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve,dhe gjobe në lartësi prej 120.euro,i cili nuk do të ekzekutohet po

nga deklarata e deshmitarit [REDACTED], por edhe nga deklarimi I vet te akzuarit ne hetuesi

Gjykata ka vlersuar se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale vjedhje nga neni 325 par 1 i KPK-së, pér të cilën vepër i akuzuari është penalishtë përgjegjës dhe është ndeshkuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Ky vlersim është i bazuar në pranimin e pjeshem të fajsisë nga ana e të akuzuarit, deshmia e deshmitarit [REDACTED] porse edhe leximi I deklarates se [REDACTED] si dhe prova te tjera qe gjenden ne shkresa te lendet. është zbuluar se i akuzuari ka kryer veprën penale siq është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjës së denimit gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 75 i KPK-së të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese pér të akuzuarin gjykata ka marrë pér bazë gjendjen ekonomike të akuzuarit, pendimin e tij, sjelljen e mirë të tijë gjatë tërë procedures si dhe në shqyrtimin gjyqsor, si dhe faktin se ai më pare nuk ka qenë i gjykuar, ndërsa rrethanë rënduese se kjo vepër penale është dukuri e shpeshtë dhe mjaftë e përhapur.

Gjykata është e bindur se denimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e pergjegjisise penale të akuzuarit dhe peshën e vepres penale, keshtu që denimi i shqiptuar në lartësi prej 90 ditësh burg dhe gjobe prej 120 euro me kusht, do arrihet qëllimi i denimit i parapaprë me nenin 41 të KPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPK-së.

Vendimin qe te udhzoj palën e demtuar per realizimin e kerkes pasuroro-juridike ne procedure kontestimore eshte i bazuar ne nenin 463 te KPPK-se.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega në Kaçanik
P. nr. 103/15 Me dt. 21.12.2016**

Sek. Juridike,
Shpresa Hoxha

Gjyqtari,

Shabi Idrizi



KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa I drejtobet Gjykates se Apelit ne Prishtinë permes kësaj Gjykate.

REPUBLICA FEDERATIVA
KOSOVA
DITUA LASHTE PLOTFUGA
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ DEGA NE KACANIK
DITUA 23.12.2016
APELI
23.12.2016
R